

Korçë/ Sherr mes të rinjsh, një 19-vjeçar qëllon 5 herë me armë në ajër! Automatikun e hedh ne ujë për të zhdukur provat, arrestohet

Të shtëna me armë zjarri u regjistruan mëngjesin e kësaj të premte (25 dhjetor) në Korçë. Mësohet se kjo ka ardhur pas një sherri mes të rinjsh në lagjen nr.17 ose siç ose siç njihet ndryshe si lagjia e Radanecit.



KORÇË -Të shtëna me armë zjarri u regjistruan mëngjesin e kësaj të premte (25 dhjetor) në Korçë. Mësohet se kjo ka ardhur pas një sherri mes të rinjsh në lagjen nr.17 ose siç ose siç njihet ndryshe si lagjia e Radanecit. 19-vjeçari Emiljano Sali ka qëlluar 5 herë me armë në ajër pas një konflikti me 2 persona të tjerë. Pas ngjarjes ai është larguar por është arrestuar pas disa orësh nga policia. Në vendngjarje janë gjetur 5 gëzhoja të armëve.

19-vjeçari u kap nga forcat e policisë në lagjen nr. 9, Korçë, me mjedin tip "Benz", i cili për t'iu shmangur përgjegjësisë ligjore, kishte hedhur armën e zjarrit tip automatike, që dyshohet se përdori në ngjarje, në një depozitë uji.



LEXO EDHE:
Të shtëna me armë zjarri në Dibër, plagoset një person (EMRI)

Arma e zjarrit së bashku me automjetin u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Rendit zhvillimet sipas orarit: **Te Fundit**

Ora 15:58
Arrestohet 19-vjeçari që qëlloi me armë në ajër pas konfliktit në Korçë (VIDEO)

Pas disa orësh i shpallur në kërkim është arrestuar 19-vjeçari Emiljano Sali, i cili qëlloi me armë mëngjesin e sotëm në lagjen nr.17 në Korçë. Ai qëlloi 5 herë me armë në ajër pas një konflikti me 2 persona të tjerë. Report Tv siguron foton e të riut, që qëlloi me armë në ajër.



Ora 11:41
Korçë/ Pas sherrit me dy persona, një 19-vjeçar qëllon me armë në ajër



Lidhur me të shtënat me armë të regjistruara mëngjesin e sotëm në Korçë, policia njofton se ka qenë një 19-vjeçar me iniciale E.S. i cili ka përdorur armën.

Ai është konfliktuar me 2 persona të tjerë dhe më pas është larguar nga vendngjarja teksa policia vijon kërkimet.

Grupi hetimor po grumbullon prova që do t'i shërbejnë hetimit, po kqyr pamjet filmike dhe po punon për kapjen e autorit të dyshuar si dhe sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes.



E.M./I.K./Shqiptarja.com
TAG: korce sherr të shtëna me arme

Ndalohet reptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

com

Sondazhi i ditës:

A besoni se anëtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese nuk do të ndikohen politikisht?

Po

Jo

Nuk e di

Komento

Lajme të tjera

Aktualitet

'Kushtetuesja' me 7 anëtarë/ Shefja e ONM: Lajm i mirë! Hap i madh në plotësimin e Gjykatës para 31 dhjetorit

28 Dhjetor, 22:33

Aktualitet

COVID-i i merr jetën mësuesit të njohur në Kukës

28 Dhjetor, 22:25

Aktualitet

Rusia letër Shqipërisë: Jemi gati t'iu sjellim vaksinën Sputnik-V kundër COVID! Pse pikërisht në këtë moment kjo ofertë?

28 Dhjetor, 22:08

Aktualitet

Përkeqësimi i motit, pezullohen lundrimet në Portin e Durrësit në drejtim të Barit

28 Dhjetor, 21:56

Aktualitet

'Kushtetuesja' me 7 anëtarë, Kim: S'mund të ketë pushim derisa të plotësohen 9 vendet

28 Dhjetor, 20:41

Aktualitet

'Kushtetuesja' me 7 anëtarë, Soreca: Përforcon funksionalitetin e Gjykatës! Përgëzoj Metën dhe KED

28 Dhjetor, 20:21